



SHERIATI

marrëdhënie mes fesë
dhe politikës në Islam

HAZRET MIRZA TAHIR AHMED^{ra}

SHERIATI marrëdhënie mes fesë dhe politikës në Islam

Ligjëratë e mbajtur nga:

Hazret Mirza Tahir Ahmed

Allahu e mëshiroftë

Kalif i Katërt i Mesihut të Premtuar

në Konsultën ndërfaqetare, Surinam,
më 3 qershor 1991

Tiranë, 2016

Sheriati – marrëdhënie mes fesë dhe politikës në Islam

Autor: *Hazret Mirza Tahir Ahmed* Allahu e mëshiroftë
Kalif i Katërt i Mesihut të Premtuar

(Albanian translation of “*Shariah - Relationship between Religion and Politics in Islam*”)

Ligjëratë e mbajtur në anglisht, më 3 qershor 1991, në Surinam.

Botimi i parë në shqip: 2016

© Islam International Publications

E përkthet nga origjinali: Sait Saiti
Redaktor gjuhësor: Samad Ghori

Botues:

Islam International Publications Ltd.
Islamabad, Sheephatch Lane,
Tilford, Surrey GU10 2AQ, UK

Design: Petani Design, Tiranë

U shtyp në shtypshkronjën: Gent.grafik, Tiranë

Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni:

Anglisht: www.alislam.org

Shqip: www.alislam.al

ISBN: 978-1-84880-260-5

Parathënie

Në botën e sotme, ligji i Sheriatit shpesh zë titujt kryesorë të medias botërore, si simbol i terrorizmit dhe shtypjes “islamike”. Ndjeshmëria rreth kësaj çështjeje i ka polarizuar popujt. Disa kombe e shtete perëndimore kanë shkuar deri në ekstremin që miratuan legjislacione kundër ligjit të Sheriatit. Sidoqoftë, fakti është që këto ekstreme janë ushqyer nga frika dhe keqkuptimi, për pjesën më të madhe të të cilave përgjegjës të drejtpërdrejtë janë muslimanët.

Në ligjëratën e tij të drejtuar IRIS-it (Konsulta ndërfaqetare në Surinam), të titulluar “Sheriati – marrëdhënie mes fesë dhe politikës në Islam”, *Hazret Mirza Tahir Ahmed* r.a. analizon nga kënde të ndryshme kompleksitetin e implementimit të ligjit të Sheriatit. Cilësimi i tij është jashtëzakonisht i gjindshëm për strukturat moderne të qeverisjes në shoqëritë pluraliste. Megjithatë, në të gjitha përfundimet e tij, ai bazohet drejtpërdrejt në Kuranin Famëlartë, hadithet dhe praktikën profetike.

Ai gjithashtu nxjerr në pah hipokrizinë e dëshmuar rëndom në disa vende islamike. Ai me të drejtë i këshillon muslimanët që, së pari të reformojnë vetveten, përpara se të imponojnë në mënyrë tiranike mbi të tjerët interpretimin e tyre të ligjit të Sheriatit. Ai tregon se kombinimi i këtyre faktorëve ka krijuar situata, të cilat e bëjnë ligjin e Sheriatit jopraktik, madje, despotik dhe kundër asaj fryme, për të cilën ai ishte hartuar.

Përkthimi i kësaj ligjërate në shqip është bërë nga z. Sait Saiti dhe redaktimi nga z. Samad Ghorri.

Zoti i shpërbleftë!

Ues-selam

Munir-ud-Din Shams

Add. Vakilut-Tasnif

(Drejtor i botimeve të Xhematit Musliman Ahmedia)

25 shtator 2016

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit

FJALA E HAPJES E KRYETARIT

Duke i uruar mirëseardhjen *Hazret Mirza Tahir Ahmedit* në takim

Është një privilegj për mua t'ju uroj mirëseardhjen në këtë takim në emër të IRIS dhe të bashkësisë së këtushme. IRIS domethënë 'Inter-Religiousraat In Suriname' ose "Konsulta Ndërfetare në Surinami".

Mirë se erdhët në takimin tonë. Keni tashmë një javë që jeni këtu dhe siç mund ta keni ndjerë, jeni fort të mirëpritur në Surinam, i cili njihet vendi i mikpritjes dhe i buzëqeshjes.

Ne kemi lexuar tashmë diçka për personin, edukimin dhe formimin tuaj. Gjithashtu sa i përket misionit tuaj në Surinam dhe në botë. Dhe, me sa kuptuam, misioni juaj është kryesisht që të bashkojë njerëzit: njerëz të racave, të vendeve dhe të kulturave të ndryshme. Dhe mesazhi juaj është një mesazh respekti për njëri-tjetrin, të menduarit respektshëm, pranimit dhe ndërkuptimit, për të sjellë drejtësinë dhe paqen midis njerëzve.

Është në këtë kontekst që ne ju ftuam këtë mbrëmje për të qenë me ne këtu, me IRIS dhe këtë bashkësi, për të bashkëndarë me ju, këndvështrimet tona, mendimet dhe idetë tona mbi këtë çështje.

IRIS është një grup prijësish fetarë në Surinam dhe ekziston që dy-tre vjet. Por deri më tani, ne jemi përqendruar vetëm në të punuarit së

bashku, në vend të të dialoguarit së bashku. Duke punuar së bashku për mirëqenien e popullit të Surinamit. Dhe në këtë bashkëpunim, ne kemi patur projekte të ndryshme deri më tani.

Por tanimë, ne duam të hyjmë edhe në dialog, për të bashkëndarë këndvështrimet tona, fetë tona me njëri-tjetrin. Prandaj ne planifikojmë gjithashtu të përdorim ndihmën e folësve të ftuar. Dhe kështu, ju jeni i pari folës i ftuar në kontekstin e këtij programi të dialogut ndërfitar mes feve këtu në Surinam. Ne ju falënderojmë për gatishmërinë tuaj për të ardhur dhe bashkëndarë këndvështrimet tuaja me ne. Tema për këtë mbrëmje është **Sheriati ose marrëdhënia mes fesë dhe politikës në Islam**. Dhe kjo është kundër prapavijës së bashkëpunimit të feve të ndryshme në një vend.

Dhe tema e dytë në agjendë është, çështja Ahmedia. Prapavija më e thellë e përndjekjes së muslimanëve ahmedianë.

Edhe një herë ju falënderojmë që keni ardhur këtu dhe shpresojmë që kjo mbrëmje për ju dhe për ne të jetë një dialog i kënaqshëm, një përvojë vëllazërore dhe e frytshme në dobi të një marrëdhënieje më të mirë mes feve të ndryshme këtu në Surinam dhe në botë. Ju ftoj tani t'i drejtoheni bashkësisë sonë.

FJALIMI I HAZRET MIRZA TAHIR AHMEDIT

Pas recitimit të *teshehudit* dhe të *tavudhit* në arabisht, Hazret Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar tha:

Hirësia juaj Ipeshkëv, Sekretari i Përgjithshëm i kësaj Shoqate dhe të gjithë të ftuarit e shquar, zonja dhe zotërinj!

Është vërtetë një nder i shënuar për mua të jem i ftuar këtë mbrëmje, si folësi i ftuar i parë në historinë e kësaj Shoqate.

Është një moment historik për mua, të bashkëndaj këtë përvojë dialogu të lirë, të pjekur dhe pa ngacmime me ju, thjesht për të bashkëndarë këndvështrimet tona si qenie njerëzore normale, krejt njerëzishëm, për të bërë veten më të kuptueshme për të tjerët dhe për t'u përpjekur t'i kuptojmë më mirë të tjerët. Ky është synimi i dialogut të lirë dhe jam kaq i kënaqur që keni ndërmarrë një nismë kaq fisnike, sepse sot bota ia ka shumë nevojën në çdo rrethanë të jetës.

Sa i përket çështjes ndaj së cilës dëshironi që të flas, më duhet të kërkoj falje së pari, duke vënë në dukje se të dy çështjet janë shumë të gjera, dhe mbase me kohën e kufizuar në dispozicion, nuk do të jetë e mundur për t'i dhënë hakut secilës prej tyre. Kësodore propozoj që pasi të mbaroj me çështjen e parë, e cila është Sheriati dhe Politika, Ligji i Sheriatit dhe vendosja e ligjit të Sheriatit në çdo vend, e nëse gjejmë më shumë kohë, atëherë do t'i kthehem temës tjetër. Përndryshe, do të na duhet ta lëmë me aq. Kështu do të keni mundësinë të bashkëndani këndvështrimet tuaja dhe të bëni pyetje, nëse dëshironi.

Gjithsesi do të mundohem t'i bie shkurt, por gjithashtu duhet të jem gjithëpërfshirës. Ligji i Sheriatit është një çështje që tani po debatohet nxehtësisht ndër vendet muslimane.

Hyrja në fuqi e shariatit në Pakistan

Së voni Pakistani ka qenë logu i kësaj polemike të nxehtë dhe ndonjëherë të dhunshme, sa i përket Sheriatit. Në përgjithësi, konsiderohet, në qoftë shumica e vendit e përbërë prej muslimanësh, atëherë muslimanët kanë të drejtën, madje detyrimin, të miratojnë ligjin e Sheriatit. Pohohet që nëse besojnë në Kuranin e Shenjtë dhe nëse besojnë se Kurani i Shenjtë është një Libër gjithëpërfshirës që lidhet me çdo fushë të veprimtarisë njerëzore dhe drejton njeriun se si duhet të sillet në çdo rrethanë të jetës, atëherë është hipokrizi të rrinë të kënaqur me ato mëtesa. Ata duhet të ndjekin përfundimin logjik dhe të miratojnë Sheriatin e ta bëjnë ligjin e vetëm të vlefshëm për vendin.

Tani, kjo është çka thuhet nga njëra anë. Nga ana tjetër, shumë vështirësi po vihen në dukje, siç janë problemet legislative të propozuara, problemet kushtetuese dhe shumë probleme të tjera serioze, gati në çdo rrethanë të hyrjes në fuqi të Sheriatit. Kështu që, lejomëni t'ju them shkurtimisht, pse ligji i Sheriatit nuk mund të zbatohet ose nuk mund të imponohet në një popull që nuk janë muslimanë idealë, aq sa i përket mënyrës normale të jetesës së tyre, përkundrazi. Në vendet ku ata janë të lirë të ushtrojnë Islamin, ata kanë kaq shumë mangësi, sa që habitesh se kur nuk e ushtrojnë vetiu Islamin, si mund të pritet që ta bëjnë në saje të shtrëngësës dhe forcës së ligjit?! Kjo dhe shumë të tjera janë hullitë ku debati po vazhdon dhe ndiqet nxehtësisht, por unë tani, shumë shkurt do të rendis pikat që t'ju bëj të kuptoni të gjitha anët e çështjes.

Personalisht, unë kam marrë pjesë gjithashtu në debatin që po vazhdonte në Pakistan dhe shumë studiues që erdhën në Londër ose që më shkruan për udhëzime, u ndihmuan prej meje. Megjithëse nuk u diktova tërësisht shënime atyre, por në një shkallë të madhe u ndihmuan prej meje që të kuptonin problemin në një kënd më të gjerë. Kështu që shumë artikuj që janë botuar në Pakistan, kishin qëndrimin tim të shprehur ndër ta.

Sheriati është ligji dhe nuk ka dyshim për këtë, ligji i muslimanëve. Por çështja është se sa shumë mundet ky ligj të ndryshojë drejt një legjislacioni për qeveritë politike. Në krye të kësaj, shumë çështje të tjera përfshihen në të. Për shembull, një vend musliman ka të drejtën t'i diktojë ligjin e vet mbarë popullsisë së vet, por, me të njëjtin arsyetim dhe të njëjtin logjikë, çdo vend tjetër me shumicën e popullsisë që u përket feve të tjera, do të kishin po të njëjtin tagër të miratojnë ligjet e tyre.

Bota mbarë do të bëhej një vend jo vetëm me konflikte politike, por gjithashtu një vend konfliktesh politiko-fetare, ku të gjitha ligjet do t'i atribuoheshin Zotit, megjithatë, do të kundërshtonin njëri-tjetrin diametralisht. Do të kishte një pështjellim të atillë, saqë njerëzit do të humbitnin besimin e tyre në Zotin, i cili u flet një gjë një populli dhe një tjetër popullit tjetër, dhe i cili u thotë ta imponojnë këtë ligj mbi njerëzit ose 'ata do të jenë jo besnikë ndaj Meje'.

Kësajde, ju mund ta përfytyroni lehtë çka do të ndodhte në Indi për shembull, nëse ligji i shumicës hindu do t'i imponohej pakicës muslimane. Çështje e vërteta, një pjesë e madhe e shoqërisë indiane, po shtyhet shkallazi drejt kërkesave të tyre ekstremiste. Kjo, sipas mendimit tim, është në formë reagimi ndaj asaj që po ndodh në vendet e tjera islamike. Çka do të ndodhte me muslimanët dhe minoritetet e tjera në Indi? Për më tepër që kjo nuk është çështje e

Indisë në veçanti. Po nëse Izraeli miraton ligjin e Judaizmit, ligjin e Talmudit, e kam lexuar dhe e di se do të jetë e pamundur për çdo johebre të jetojë normalisht dhe njerëzisht atje.

Në të njëjtën mënyrë, Krishterimi ka të drejtat e veta, ashtu si edhe Budizmi.

Pjesëmarrja në legjislacion

Konsiderata e radhës është vetë koncepti i shtetit: Kjo është çështja më themelore që duhet zgjidhur dhe adresuar nga ata që janë të interesuar pas politikës dhe të drejtës ndërkombëtare. Çështja është që kushdo që është i lindur në një shtet, ka të drejtë të marrë pjesë në legjislacion.

Në konceptin shekullar të funksionimit të qeverive dhe të legjislacionit, çdo i lindur në një vend të dhënë, cilado qoftë feja apo ngjyra apo besojma e tij, fiton të drejtat njerëzore themelore. Si më e rëndësishmja e këtyre të drejtave është së paku mundësia për të marrë pjesë në formimin e legjislacionit.

Sigurisht, partitë shkojnë e vijnë. Partitë e shumicës sot, mund të bëhen partitë e pakicës nesër. Dëshira e gjithsecilit nuk përmbushet apo arrihet. Por në parim, çdokush ka një mundësi të drejtë e të barabartë për të bërë që fjala e tij të dëgjohet, së paku nga opozita, mbi bazat e një parimi të përbashkët. Por çfarë do të ndodhte nëse një shariat ose një fe imponohet si ligji i një vendi? Nëse ligji musliman do të imponohej në një vend, mbarë pjesa tjetër e njerëzve që janë banorë të të njëjtit vend, do të duhej të konsideroheshin si qytetarë të shkallës së dytë, të tretë dhe të katërt të të njëjtit vend me asnjëfarë përfaqësimi në legjislacion. Por kjo nuk është e gjitha, problemi është më tej i ndërlikuar brenda vetë muslimanëve: Islami ka një Libër të

shpallur prej Zotit, por dijetarët muslimanë pretendojnë se është e drejta e tyre për ta interpretuar atë.

Organi legjislativ vartës i dijetarëve fetarë

Mbi çështjet e dallimit të qëndrimeve, trupi legjislativ rri vartës i qëndrimeve skolasitike të dijetarëve që specializohen në interpretimin e Kuranit të Shenjtë; ose që pretendojnë se specializohen në interpretimin e Kuranit të Shenjtë. Cila do të jetë marrëdhënia e tyre e ndërsjellë? Një organ legjislativ është zgjedhur për ligjvënien. Ata nxjerrin një ligj dhe ju dëgjoni prej disa dijetarëve të Islamit: “çka ju keni propozuar si ligj, bie ndesh me parimet themelore të Islamit. Islami nuk ka vend për këto gjepura!”

Cili zë duhet të dëgjohet? Në një anë, do të dukej sikur të ishte Zoti që flet mbrapa atyre njerëzve; por vetëm në dukje. Nga ana tjetër, do të ishte zëri i shumicës së popullit të vendit. Kështu që dilema bëhet gati e pamundur për t’u zgjidhur.

Të gjitha fetë ndahen në sekte me kohën

Por kjo nuk është e gjitha. Çdo fe, në burim është një e vetme dhe e pandashme, por me kalimin e kohës, ajo nis të devijojë e të përçahet përbrenda, duke u shumuar në numër gjithnjë më të madh. Për shembull, në kohën e Jezu Krishtit (paqja qoftë mbi të) kishte një krishterim të vetëm, që tani është shndërruar në qindra krishterime. Këqyrur nga pozita e sekteve të ndryshme, i vetmi burim shfaqet me ngjyresa të ndryshme. Syze me ngjyra të ndryshme përdoren nga ndjekës të ndryshëm të sekteve të ndryshme. E njëjta gjë vlen edhe për Islamin. Nuk është vetëm një çështje e Islamit sunni apo e Islamit shi’i dhe se si ata e interpretojnë Sheriatin.

Përbrenda Islamit shi'it ka 34 sekte, interpretimi i të cilëve dallon. Sërish përbrenda Islamit sunni ka të paktën 34 sekte, interpretimi i të cilëve dallon nga njëri-tjetri. Nuk ka çështje në të cilat dy ulemá (dijetarë) sektesh të ndryshme bien në ujdi, jo vetëm çështje sipërfaqësore, madje, edhe çështje themelore. Mjafton të lexoni vetëm Raportin Hetues “Munir”. Gjyqtari Munir, Kryegjyqtari i Gjykatës së Lartë [të Pakistanit] qe njëri prej dy gjyqtarëve që u caktuan për të hetuar prapavijën, arsyet dhe mënyrën e veprimit të revoltave anti-ahmedia, në vitin 1953. Kush kishte përgjegjësi e kush nuk kishte? Si ta përkufizonin një musliman?

Si të përkufizojmë muslimanin?

Gjatë rrjedhës së hetimit, gjyqtari Munir qartazi pyeti çdo dijetar musliman që i dilte para, në dinte një përkufizim në Islam, i cili të ishte i pranueshëm edhe nga sektet e tjera po ashtu, që të mund të aplikohesh me barazi tek të gjithë dhe me ndihmën e të cilit ata do të mund të pohonin: “po, ky është musliman” dhe “ky nuk është musliman”. Në raport, gjyqtari Munir pohon se, ndër të pyeturit, as dy dijetarë muslimanë nuk binin në ujdi përmbi qoftë një përkufizim të vetëm se çfarë Islami është.

Një dijetar në veçanti donte më shumë kohë të mendohej. Gjyqtari Kajani, që ishte koleg me gjyqtarin Munir, kishte një sens humori fort të veçantë, iu përgjigj atij:

“Nuk mund t’ju jap më shumë kohë, sepse ju tashmë i keni marrë 13 shekuj për ta peshuar këtë pyetje. A nuk janë mjaftueshëm? Nëse trembëdhjetë shekuj plus disa vite nuk janë mjaftueshëm për ju për të përkufizuar vetë themelet e Islamit se cili është përkufizimi i tij, sa kohë do t’ju duhet?”

Pra, kjo është një çështje shumë e rëndë. Nëse interpretimi i Sheriatit i njërit sekt imponohet, atëherë nuk do të jenë vetëm jomuslimanët të cilët do të zhvishen nga të drejtat themelore të pjesëmarrjes në ligjvënien e vendit, por gjithashtu përbrenda Islamit do të ketë shumë sekte që do të privohen nga kjo e drejtë.

Interpretimi i cilit sekt duhet të vendoset në Ligjin e Sheriatit?

Sërish, ka edhe shumë probleme të tjera. Për shembull, sipas disa koncepteve të Sheriatit, ndëshkimi për një krim është kaq i ndryshëm nga koncepti i një sekti tjetër, sa që do të duket se Islami praktikohet në botë kaq ndryshe për të njëjtën çështje dhe do të lërë një mbresë të tmerrshme në botën jomuslimane. Çfarë lloj besimi është ai që udhëzon një ndëshkim për të njëjtin krim ndryshe këtu dhe ndryshe atje, ndërsa në vende të tjera është e drejtë ta bësh dhe nuk përbën krim fare?!

Këto dhe shumë çështje të tjera përbëjnë çështjen e vendosjes së Sheriatit gati të pamundur.

Për më tepër, në shumë situata të mundshme manipulohen ose shkelen të drejtat themelore të sekteve të tjera. Për shembull, çështja e të pirit alkool. Alkooli është i ndaluar në Islam, në rregull; por, në është një fyerje e ndëshkueshme apo jo, e, nëse po, a do të vendoset ndëshkimi nga njeriu, kjo është çështja. Cili është ndëshkimi i të pirit? Kurani i Shenjtë nuk përmend ndonjë ndëshkim. Ky është një ligj themelor, ligji i Librit, ndërsa ndëshkimi i të pirit nxirret nga disa hadithe, nga disa dijetarë. Por ky vendim është i sforcuar dhe hadithet vetë janë sprovuar nga të tjerë që nuk janë autentike.

Pra, një pjesë e gjerë jo vetëm e shoqërisë muslimane, por gjithashtu një pjesë e gjerë e shoqërisë jomuslimane, do të dënohet për arsye të tilla, që në vetvete janë të dyshimta. Qoftë e vlefshme ose jo, kjo është çështja. Megjithatë, kudo ka ekstremistë, veçanërisht ata që mëtojnë se Sheriati duhet të imponohet.

Ju do të gjeni shumë ekstremistë që janë tërësisht jotolerantë ndaj qëndrimit të tjerëve. Si pasojë, zona të tilla gri gjithashtu do të merren si zona me qëndrim të mirë nga ekstremistët. Ata do të thonë: “Po, ne e dimë; ky është qëndrimi ynë. Është qëndrimi i mbështetur nga një dijetar mesjetar i shkollës sonë. Dhe ky është ligj”

Vështirësitë e përballuara nga qeveria e Pakistanit për miratimin e ligjit të Sheriatit

Tanimë ky dallim çoi rishtazi në një debat në Pakistan dhe Nawaz Sharif, kryeministri, kishte për të vendosur përfundimisht që nuk do të pranohej Sheriati i asnjë sekti.

Ligji që u miratua në Pakistan do të pranojë epërsinë e Kuranit dhe, ata do të bien në godi që asnjë legjislacion nuk do t’u bjerë ndesh mësimave themelore të Kuranit. Por përtej kësaj, ata nuk do të adoptojnë norma dhe rregullore të tjera që burojnë nga ligje, sepse thuhet se janë udhëzime legjislative prej Zotit.

Pra, duke e lënë këtë mënjane, çka mbetet prej Sheriatit është parimi i përgjithshëm i shpallur në Kuranin e Shenjtë, në dritën e të cilit do të bëhet një përpjekje për islamizimin e ligjit të një vendi.

Deri tani mirë. Mendoj se kryeministri e ka nxjerrë veten prej një situatë shumë të vështirë, por jo për shumë kohë. *Ulematë* i janë tashmë në fyt. Gjithashtu, ata po këmbëngulin që një Gjykatë Sheriati

jo vetëm të vazhdojë të punojë (ka tashmë një Gjykatë Sheriati atje), por fuqia e saj duhet të rritet. Autoriteti përfundimtar lidhur me nëse ligji është apo jo sipas Islamit, duhet të paraqitet pranë Gjykatës së Lartë të Sheriatit.

Kështu, sërish ekuilibri i pushtetit do të zhvendoset prej delegatëve të përzgjedhur të vendit, drejt mullahëve ekstremistë. Një herë të pranoni diçka, që nuk është praktike të vendoset, kjo do të çojë gjithnjë drejt trazimeve të ndryshme dhe do të jetë e pamundur për ju t'ia dilni pa ndërlikime të mëtejshme.

Mënyra e jetesës së muslimanëve të sotëm nuk është krejt islame

Kjo është një fushë vështirësish. Por ka edhe një fushë tjetër shumë të rëndësishme me vështirësi, që është: mënyra e jetesës e muslimanëve ndër shumë vende nuk është vërtetësisht dhe thellësisht muslimane.

Mendoni pak, nuk ju duhet ligji i Sheriatit për të falur pesë namazet e përditshme. Nuk ju duhet vendosja e ligjit të Sheriatit për t'ju bërë të silleni ndershmërisht. Nuk ju duhet vendosja e ligjit të Sheriatit që t'ju bëjë të thoni të vërtetën e të dilni si dëshmitar ndershmërisht dhe vërtetësisht në gjykatë ose kudo qoftë. Por, në një shoqëri ku vjedhja është bërë rendi i ditës, ku ka mungesë rregulli, kaos, uzurpime të të drejtave të tjetrit, ku Gjykatat rrallë kanë dëshmitarë të vërtetë, ku gjuha e ndyrë është një mënyrë shprehje e zakonshme, ku nuk ka më hijeshi në sjelljen njerëzore, çfarë prisni që të bëjë Sheriati aty? Si do të mund të vendoset çiltërsisht Sheriati në një vend të tillë, kjo është çështja.

Atmosfera e përshtatshme që kërkohet për vendosjen e ligjit të Sheriatit

I kam dhënë një trajtë tjetër kësaj çështjeje dhe sigurisht kjo është debatuar, e deri më tani, nuk kam dëgjuar ndonjë përgjigje që vërtet do t'i japë zgjidhje kësaj problematike.

Çështja është se çdo vend ka një klimë dhe jo e gjithë flora mund të lulëzojë në atë klimë. Hurmat lulëzojnë në shkretëtira, por jo në veriun e ftohtë. Ngjashëm, qershitë nuk mund të mbillen në shkretëtirë, ato kërkojnë klimë të posaçme. Sheriati gjithashtu kërkon një klimë të posaçme. Nëse nuk e ke krijuar atë klimë, Sheriati nuk mund të vendoset.

Çdo profet, jo vetëm Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të), së pari krijoi një klimë të shëndetshme që ligji i Zotit të vendoset, vullnetarisht dhe jo me imponim. E kur shoqëria ishte gati, atëherë ligjet përfutëshin dhe fuqizoheshin herë pas here, derisa të shpallej mbarë kodi. Ajo shoqëri ishte e aftë të mbante barrën e ligjit të fesë, të cilin, daç e quani ligj i Sheriatit, daç diçka tjetër.

Në një shoqëri për shembull, ku vjedhja është gjë e zakonshme, gënjeshtër është një praktikë e përditshme, nëse miratohet ligji i Sheriatit dhe priten duart e atyre që vjedhin, çfarë do të ndodhë? A është ky qëllimi i Sheriatit? Kjo nuk është një çështje sentimentalizmi ndaj fesë. Vullneti i Zotit do të bëhet patjetër, por do të bëhet në udhën e renduar, siç Zoti dëshiron që ne të bëjmë.

Ligji i Sheriatit i përdorur si një pretekst për të marrë pushtetin

U kam sugjeruar disa liderëve politikë që, së pari, ata duhet të ftojnë të gjithë dijetarët muslimanë që të reformojnë një qytet të vogël të Pakistanit e pastaj, ta miratojnë Sheriatin aty. Për shembull, Fejselabadi (Faisalabad) është një qytet i vogël, ose një qytezë e madhe, kryesisht me tregtarë, të famshëm për sjelljet e tyre të mbrapshta.

Propozova që *ulematë* duhet të ftoheshin nga mbarë Pakistani për të reformuar së pari banorët e atij qyteti. Kur njerëzit e atij qyteti të aftësohen për të mbajtur barrën e Sheriatit, atëherë qeveria duhet të ftohet për të marrë përsipër administrimin e ligjit të Sheriatit. Por, kjo nuk do të ndodhë. Atyre nuk u intereson. Nuk i shqetëson kjo gjë. Nuk është dashuria për Islamin që i shtyn ata të kërkojnë ligjin e Sheriatit. Është thjesht një mjet për të arritur e për ta kapur pushtetin dhe për ta udhëhequr shoqërinë në emër të Zotit. Shoqëria tashmë po udhëhiqet nga njerëz të korruptuar e mizorë, por kjo po bëhet në emër të të drejtave të njeriut; kjo është e tolerueshme deri në një pikë. Por kur mizoritë kryhen në emër të Zotit, ajo është gjëja më e keqe dhe më e shëmtuar e mundshme që mund t'i ndodhë njeriut.

Kështu që, ne duhet të mendojmë shumë, shumë herë para se të nisim ta peshojmë pyetjen nëse mund të vendoset ligji fetar ndokund në botë si tender ligjor. Për vete, dyshoj.

Tani, këtu do ta ndal çështjen për pakëz. Nëse mendoni se ka kohë t'i drejtohem pyetjes së dytë, do ta bëjmë. Përndryshe, do të ulemi e të diskutojmë çka kemi thënë deri më tani.

PYETJE-PËRGJIGJE

(Pas fjalimit, shumë pyetje iu paraqitën kumtuesit dhe si vijon janë përgjigjet e disa prej tyre. Fatkeqësisht, siç do të vihet re, disa pyetje nuk janë regjistruar siç duhet, por përgjigjet diktojnë se për çfarë ishin pyetjet)

P: A ka një hutim në botën perëndimore mbi Sheriatin?

PËR: Faleminderit për këtë pyetje të goditur. Por mendoja se pyetje të tilla ishin jashtë lëmit të diskutimit.

Çka ne po diskutojmë është nëse është e mundur të adoptohet ligji fetar si ligji i një vendi, në cilindo vend e nga cilado fe.

Unë besoj se nuk është e mundur. Nuk është e mundur edhe nëse dëshironi pastërtisht dhe me zell, në emër të Zotit. Ne i jemi larguar aq shumë fesë. Ne jemi bërë hipokritë. Mbarë shoqëria njerëzore është bërë hipokrite. Ka hipokrizi në politikë dhe në shoqëri, kudo. Dhe hipokrizia nuk e lejon ndershmërinë të lulëzojë. Ajo nuk e lejon fjalën e Zotit të zërë rrënjë. Ky është problemi kryesor.

P. Unë mendoj se nuk mundemi ta aplikojmë në të vërtetë një ligj që ka ardhur prej kohërave të hershme për kohët e sotshme. Mund të na shpjegoni ju lutem?

PËR. E kam studiuar këtë çështje me thellësi. Besoj se feja mund të jetë e përhershme dhe universale, për sa kohë që parimet e saj janë të rrënjësura thellë në psikikën njerëzore. Psikika njerëzore

është e pandryshueshme. Kjo është saktësisht ajo çka pohon Kurani i Shenjtë. Ai thotë se Kurani është “*Dinul-fitrah*”, domethënë, besim ose rend i bazuar në natyrën njerëzore. Gjithashtu, ai thotë:

لَا تَبْدِيلَ لِخَلْقِ اللَّهِ

“Nuk ka ndryshim në krijimin e Allahut”

(Kurani Famëlartë 30:31)

Pra, krijimi i Zotit dhe gjithçka që Zoti ka krijuar brenda jush, tagërdhënia, rendimet, etj. dhe prirja bazë për të bërë apo jo diçka, të gjitha këto ngelen të njëjtat.

Rrjedhimisht, çdo ligj që është i rrënjosur në psikikën njerëzore, duhet të jetë gjithashtu universal dhe i përhershëm. Por, Kurani i Shenjtë nuk ndalet këtu. Ai nuk e monopolizon të vërtetën. Ai vazhdon duke thënë se të gjitha fetë, në fazat e tyre fillestare dhe zhvillimore, në thelb ishin të njëjta dhe që të gjitha mbartnin të vërteta bazë të tilla, që lidhen me natyrën njerëzore. Kjo është gjithashtu e përmendur në Kuran si “*Dinul-kejim*”. Thuhet se çdo mësim fetar ka **tri** tipare themelore:

Së pari, të kujdesesh për marrëdhëniet e tua me Zotin, të jesh i ndershtëm dhe i dhënë pas Tij.

Së dyti, ta adhurosh Atë. Në kuptimin kuranor, adhurim nuk do të thotë ta përnderosh me fjalë boshe; por të përpiqesh t'i përftosh brenda vetes vetitë e Zotit.

E së treti, t'i shërbesh njerëzimit dhe të shpenzosh për nevojat e nevojtarëve.

Sipas Kuranit të Shenjtë, këto janë tri degë themelore, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha fetë. Megjithatë, me kalimin e kohës dhe përmes ndërhyrjeve njerëzore, ato u ndryshuan. Pra, ajo çka nevojitet është një ndreqje e ndryshimit. Jo një besim i ri. Dhe pikërisht kjo është ajo që ka ndodhur me ardhjen e çdo profeti.

Pra, kjo është një çështje mjaft e ndërlikuar dhe, gjithashtu, jo drejtpërdrejt e lidhur me çështjen që ne po diskutojmë. Shpresoj që kjo përgjigje të jetë e mjaftueshme.

Sa i përket çështjes nëse mund të imponohet apo jo ligji i Islamit apo ndonjë ligj tjetër fetar, unë them **jo**. Sepse është kundër frymës së vetë feve. Kurani i Shenjtë thotë:

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ

“Nuk ka imponim në fe!”

(Kurani Famëlartë 2:257)

Kjo është një shpallje e Kuranit të Shenjtë, s’ka dyshim, por është një shpallje universale që nuk mund të ndryshojë kurrë. Ky është një shembull që tregon se si ligjet mund të bëhen të përhershme dhe universale. Kurani pohon se nuk ka shtrëngim në besim ose në çështjet e besimit. Asnjë shtrëngim nuk është i mundur dhe asnjë shtrëngim nuk është i lejueshëm. Pra, këtu lind pyetja: Nëse një fe vendos ligjin e saj në një shoqëri, ku jetojnë edhe njerëz të feve e të bashkësive të tjera, si do të qëndrojë ky ajet përball përpjekjeve tuaja për imponim? Jo vetëm në raport me njerëzit e besimeve të tjera, por gjithashtu edhe në raport me njerëzit e së njëjtës fe, të cilët nuk janë të gatshëm për një ligj të tillë.

Pra, kjo është pyetja themelore. Andaj, përfundimi është që imponimi nuk ekziston si mjet në fe, nuk është një mjet i lejueshëm në fe.

I vetmi autoritet i Islamit, të cilit mund t'i ishte dhënë pastërtisht tagri për imponim, ishte Profeti i Islamit, Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të). Pse? Sepse ai ishte modeli i gjallë i Islamit dhe sepse kur e pyetnin për karakterin e tij, gruaja e tij e dëlirë, *Hazret Ajshja* thoshte se ai ishte Kurani për së gjalli.

Pra, i vetmi njeri të cilit mund t'i besohej besimi i të tjerëve dhe t'i lejohej të ushtronte edhe imponim, ku ai ndjente se ndreqja duhej bërë me forcë, ishte Profeti i Shenjtë.

Megjithatë, duke iu drejtuar atij, Zoti thotë në Kuran:

إِنَّمَا أَنْتَ مُذَكِّرٌ ۖ لَسْتَ عَلَيْهِمْ بِمُصَيِّرٍ ۝١٧

“Ti je vetëm këshillues. Nuk je i ngarkuar për t'i detyruar ata.”

(Kurani Famëlartë 88:22-23)

Pra, Kurani i thotë Profetit s.a.v.s.: Ti je vetëm një paralajmërues. Jo më shumë. Ty nuk të është dhënë **asnjë** tagër për të detyruar. Ti nuk je një inspektor policie. *Musejtir* është tamam një inspektor policie.

Pra, për këtë arsye them se imponimi as nuk është i mundshëm, e as i lejuar nga Zoti. Përveç kësaj, çka e ndalon një musliman nga të ndjekurit ligjin musliman? Pse duhet të presë ai që mbarë legjislacioni të ndryshohet?

Shumica e Islamit, e Krishtëritimit dhe e Hinduizmit mund të ushtrohen pa pasur nevojë që ato të jenë ligji i vendit. Për më tepër, është pranuar si parim i përgjithshëm nga mendimtarët e politikës

moderne që feja nuk duhet të ndërhyjë në politikë dhe politika nuk duhet të ndërhyjë në fe.

E kam fjalën për ndërhyrjen, jo për bashkëpunimin. Bashkëpunimi është pjesa e dytë e së njëjtës temë. Pra, nëse shoqëria është lejuar të jetojë sipas aspiratave të tyre fetare, pse duhet që ligji i një feje të caktuar të bëhet ligji i vendit?

Po citoj një shembull se si ligji i Sheriatit ka dështuar tashmë në Pakistan. Gjatë periudhës së fundit të regjimit të Gjeneralit Zia, ishin themeluar edhe Gjykatat Muslimane të Sheriatit. Zgjedhja i ishte lënë policisë që, të akuzuarin për krim ta dërgonte drejt Gjykatës Muslimane të Sheriatit ose drejt gjykatës së zakonshme. E dini se cili qe përfundimi? Zor se ndonjë rast u gjykua nga Gjykata Muslimane e Sheriatit, sepse policia kishte rritur hiset e ryshfetit dhe kërcënonin këdo që nëse nuk do të paguanin dyfishin e ryshfetit të zakonshëm, ata do t'i shpinin për te Gjykata e Sheriatit.

Ky ishte rezultati neto. Dhe ju do të habiteni duke mësuar që ndër mijëra e mijëra zgjedhje të mundshme, thuajse dy ose tri ishin rastet që u drejtuan për kah Gjykata e Sheriatit, edhe ato në saje të trysnisë politike. Sepse disa parti politike donin të ndëshkonin armiqtë e tyre dhe donin që ato raste të trajtoheshin nga Gjykata e Sheriatit. Pra ky është realiteti i jetës. Si mund ta ndryshojmë atë?

P . Atëherë, përse ndryshojnë ligjet me ardhjen e profetëve të rinj?

PËR: Fillimisht lejomëni të them që ky përgjithësim është mbase tepër i sforcuar. Sepse kur studioni historinë e fesë, nuk është e thënë që çdo profet i ri ka ardhur për të ndryshuar ligjin e shpalljes së profetit pararendës.

Më së shumti, profetët erdhën për të përforcuar dhe riaftësuar ligjin ekzistues, sesa për ta ndryshuar.

Për shembull, nëse studioni historinë e Judaizmit, do të habiteni kur të gjeni që edhe deri te Jezusi (paqja qoftë mbi të), asnjë ligj i ri as nuk u prezantua e as nuk hyri në fuqi.

Ligjet u ndryshuan dhe u braktisën nga njerëzit dhe profetët bënë përpjekje për t'i riaftësuar njerëzit t'i praktikonin dhe t'i interpretonin sërish në dritën e zanafillës.

Pra, historia e fesë siç ne e dimë nga studimi i feve të mëdha të botës, kumton një realitet krejt të ndryshëm. Shohim Kinën, për shembull. Taoizmi erdhi si mësim. Asnjë grimë nga ai mësim nuk u ndryshua nga Konfuci. Ishte saktësisht i njëjti mësim që u përforcua dhe u interpretua sërish nga ky i fundit.

Por jam dakord që Kurani i Shenjtë gjithashtu thotë se ndonjëherë, ligjet edhe ndryshojnë. Por pyetja shtrohet se nëse ato ndryshojnë në themel apo në syprinë? Dhe si ndryshojnë? Nëse u duhet ndryshim i mëtejshëm apo jo, kjo po ashtu është pyetje shumë e rëndësishme dhe thelbësore për mua që duhet t'i përgjigjem.

Tani, do të përmend tre shembuj nga historia, të ndryshimit të ligjit natyror, duke përfunduar në vendimin përfundimtar të Islamit.

Në Judaizëm, për shkak të një historie të gjatë shtypjeje të izraelitëve prej faraonëve, izraelitët kishin humbur cilësitë njerëzore të kurajës dhe të mosbindjes, edhe kur ata kishin të drejtë. Ishte përtej fuqisë dhe forcës së tyre që ta merrnin hakun e tyre të ligjshëm, sepse kanë qenë të shkelur për shumë kohë. Kjo është e ngjashme me çka ndodh ndonjëherë me kashmirët në Indi: ata që u trajtuan mizorisht dhe pas njëfarë kohe, nisën të thoshin: “Në rregull, ne e falim armikun tonë të fuqishëm, por jo armikun tonë të dobët”.

Pra, kur shfaqen shtrembërime të tilla, atëherë vjen një ligj i përkohshëm për ta ndrequr gabimin e bërë. Kjo pikërisht është ajo që ndodhi në lidhje me ligjin e hakmarrjes të Moisiut: “Dhëmb për dhëmb; sy për sy”. Dhe, u theksua aq shumë, sikur nuk kishte vend për falje.

Ai ligj u zbatua për një kohë të gjatë. Pastaj erdhi Jezu Krishti (paqja qoftë mbi të). Deri atëherë hebrenjtë e kishin harruar vetë fjalën falje. Mjafton të lexoni Shajlokun e Shekspirit për të ditur si ishin bërë ata. Dhe, nëse edhe Jezusi (paqja qoftë mbi të) do t’i kishte lejuar ata të vijonin hakmarrjen, njerëz, të cilëve zemra u ishte ngurtësuar, kurrë nuk do të mësoheshin me falje. Për të qetësuar angëstsinë e tyre, ata do të thoshin: “Falja është e lejueshme; pse të mos marrim hak?”

Pra, Jezusi ua hoqi të drejtën e hakmarrjes. Por ky vendim nuk mund të ishte i përhershëm.

Këto janë fushat ku, ndonjëherë shpallen mësimet sipërfaqësore, por vetëm për periudha dhe kohë të caktuara dhe jo përhërë.

Pastaj vjen Kurani i Shenjtë. Ligji në lidhje me çështjen në fjalë në Kuranin e Shenjtë përmendet:

وَجَزَا سَيِّئَةً سَيِّئَةً مِّثْلَهَا ۚ فَمَنْ عَفَا
وَأَصْلَحَ فَأَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ ۝

“Dënimi i së keqes është aq sa është e keqja. Por ai që e fal dhe bën përmirësim, shpërblimi i tij është tek Allahu”.

(Kurani Famëlartë 42:41)

Pra, ju keni të drejtë të merrni hak. Ajeti i plotë thotë se ju keni të drejtën të merrni hak kur dikush ju dëmton, por **jo** tej masës së dëmit.

Ky është parimi i parë. Së dyti, ju mundeni gjithashtu të falni, por jo pa kushte. Ju mundeni të falni, nëse falja juaj sjell përmirësimin. Nëse ajo e nxit krimin, atëherë ju nuk duhet ta falni.

Tani, ky është version i Kuranit që qëndron në kulmin e zhvillimit të të njëjtit mendim. Kam takuar disa miq Bahai dhe disa dijetarë të tjerë nga vende të ndryshme të botës; kam udhëtuar shumë, dhe ua kam shtruar këtë problem duke thënë: Ju lutem, përpiquni ta ndryshoni këtë ligj, sipas normave të reja të kohës.

Deri më tani, nuk kam takuar asnjë person që mund të më propozojë ndonjë ndryshim për këtë ligj përfundimtar.

Pra, nëse ligjet janë elastike, të përshtatshme dhe të bazuara mbi parime dhe po ashtu të rrënjësura në psikikën njerëzore, unë nuk mendoj se ato të ndryshohen. Por përsëri, ky është një diskutim jashtë diskutimit kryesor. Kështu që ju lutem, shpresoj që kjo të mjaftojë dhe do t'u kthehem të ftuarve të tjerë për pyetje të tjera, nëse duan të bëjnë.

P. Ju lutem të shpjegoni dallimin mes “Sheriatit” dhe “Dinit”?

PËR. Faleminderit. Shikoni, *din* është një fjalë që aplikohet mbi çdo filozofi, çdo -izëm, çdo gjë që ju përvetësoni si mënyrë sjelljeje. Për shembull, sipas disa dijetarëve muslimanë, idhujtarët nuk kishin ndonjë “*din*” dhe këtyre dijetarëve mund t'u ngjallë neveri vetëm ideja që idhujtarët të kenë *din*. Megjithatë, duke iu referuar pikërisht idhujtarëve, Kurani i Shenjtë kumton:

لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ ۖ

Ju keni besimin (*dinin*) tuaj dhe unë kam besimin (*dinin*) tim.

(Kurani Famëlartë 109:7)

Në ajetin:

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ

“**Nuk ka imponim në fe (din)!**” (Kurani 2:257), fjala *din* përmbledh çdo rrugë që njerëzit adoptojnë si kod të jetës së tyre. Pra, ajo nuk do të thotë vetëm besimi në Zot. Edhe mohimi i Zotit mund të jetë *din*.

Kurse *Sheriati* është themeluar në konceptin e Zotit. Pra, ku një *din* është themeluar në besimin se:

(i) ka një Zot:

(ii) i cili shfaq dëshirat e Tij se si njeriu të mbrujë fatin e vet, dhe

(iii) ku vullneti i Tij është i përkufizuar në formën e ligjeve ose parimeve të caktuara. Ky quhet *Sheriat*. Jo domosdoshmërisht ai i Islamit. Çdo besim ka *Sheriatin* e vet.

Tani, pyetja është nëse *Sheriati* mund të adoptohet apo jo, edhe pse nuk është pjesë e ligjit të vendit? Ne mund të përmendim si shembull *Xhematin* tonë që kjo nuk është aspak e pamundur.

Në fakt, gati çdo vend në botë lejon anëtarët e shoqërisë së vet që të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre përmes arbitrimit. Dhe në shumicën e vendeve, sipas dijenisë sime, arbitrimi respektohet aq shumë nga ligji saqë, nëse të dyja palët firmosin për arbitrim të pakthyeshem, edhe Gjykata e Lartë nuk mund ta anulojë vendimin e tyre.

Ne kemi krijuar një bord gjykimi dhe kadinjsh në *Xhematin* Musliman Ahmedia. Të gjithë ahmedianët që nuk duan t'i drejtohen gjykatës së zakonshme për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe problemet e tyre, vijnë te ky bord që quhet “*kada*”, duke firmosur një

dokument që pohon “ne vullnetarisht dhe pa imponim, ju kërkojmë për ta zgjidhur çështjen tonë sipas ligjit të Kuranit”.

Në raste të tilla, asnjë qeveri nuk ka ndërhyrë ndonjëherë. Asnjë qeveri nuk e ka penguar ndonjëherë këtë metodë, madje ajo vazhdon qetësisht.

Në të njëjtën mënyrë, sa i përket adhurimit, edhe ai vazhdon kudo. Çdokush është i lirë ta adhurojë Zotin siç dëshiron, ose duhet të jetë i lirë. Përveç rastit të Pakistanit, ku ahmedianët nuk e gëzojnë këtë të drejtë. Por kjo është një çështje tjetër. Përndryshe, nuk ka absolutisht asnjë përpjekje të bërë nga ndonjë ligj për të ndaluar rrugëtimin e adhurimit.

Përgjithësisht, mund të themi se në shumicën e fushave të jetës, Sheriati mund të praktikohet pa u miratuar si ligj.

P. Ju keni thënë në ligjëratën tuaj, që kryeministri i Pakistanit, Navaz Sherif (Nawaz Sharif), ka vendosur që Sheriati të bëhet ligji i Pakistanit, pa përcaktuar rregulla dhe norma, por duke iu referuar Kuranit të Shenjtë. Megjithatë, ju vlerësoni se kjo nuk është një rrugë praktike. Kam vënë re se ju e keni studiuar këtë temë imtësisht. Kështu, dua t’ju pyes se ç’mendim keni lidhur me llojin e legjislacionit që një vend duhet të adoptojë. A duhet refuzuar Sheriati? A duhet modifikuar ai? A duhet një lloj legjislacioni të shekullarizuar? Cila mendoni se është zgjidhja?

PËR. Ju falënderoj shumë për këtë pyetje, të cilën duhet ta kisha trajtuar në kumtesën time. Në të vërtetë, para se të vazhdojmë më tej, duhet zgjidhur koncepti i qeverisë në Islam, që është një çështje shumë e rëndësishme.

E kam studiuar këtë çështje në thellësi. Kam studiuar dijetarët muslimanë të shekullit të kaluar, të cilët kanë folur dhe kanë shkruar shumëçka mbi këtë çështje dhe të cilët, megjithatë, nuk kanë arritur ta zgjidhnin si duhet. Nëse Islami propozon një qeveri që është përfaqësuese e Zotit, atëherë çështja duhet parë nga një kënd krejtësisht tjetër.

Nëse, nga ana tjetër, Islami propozon një sistem qeverisjeje që është i përbashkët për shumë bashkësi fetare dhe popuj të ndryshëm, shfaqet një pikëpamje krejt tjetër.

Sipas opinionit tim, rasti i parë nuk është ai që synohet. Sepse Islami synon qeverisjen sekulare, më shumë se çdo fe tjetër dhe më shumë se çdo sistem tjetër politik.

Tani, kjo mund të duket e habitshme për dikë. Por unë mund të citoj nga Kurani i Shenjtë dhe mund ta provojë këtë. Vetë thelbi i shekullarizimit është që të zbatohet drejtësia absolute, pavarësisht nga dallimet në besim, fe, ngjyrë, dhe grup.

Ky, në thelb, është përkufizimi i vërtetë i shekullarizimit. Dhe kjo është pikërisht ajo që Kurani i Shenjtë na udhëzon që të bëjmë në çështjet e shtetit, se si gjërat duhet të bëhen dhe se si shteti duhet të drejtohet. Kurani i Shenjtë kumton:

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ

“Sigurisht, Allahu urdhëron drejtësinë”.

(Kurani Famëlartë 16:91)

Pra, Zoti ju urdhëron të bëni gjithmonë drejtësinë. Ai e shtjellon temën duke thënë:

وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنَ قَوْمٍ عَلَىٰٓ اَلَّا تَعْدِلُوْا
اِعْدِلُوْا ۚ هُوَ اَقْرَبُ لِلتَّقْوٰى ۚ وَاتَّقُوا اللّٰهَ ۚ

Nuk duhet t’ju nxisë armiqësia e ndonjë populli, që ju të mos bëni drejtësi. Bëni drejtësi! Kjo është më afër druajtjes dhe kini druajtje ndaj Allahut!

(Kurani Famëlartë 5:9)

Kur të përmbushni përgjegjësinë tuaj si qeveri, duhet ta përmbushni atë me drejtësinë absolute. Kur drejtësia absolute vendoset si bërthama e një qeverisjeje, si mund ta imponojmë ligjin islamik mbi jo muslimanët? Sepse do të ishte kundër drejtësisë. Dhe do të dalin shumë kontradikta të tjera.

Kështu, nëse studioni këtë temë më me thellësi, do të habiteni duke kuptuar se interpretimi që unë po i jap kësaj çështjeje ose që unë mendoj se ky është interpretimi i drejtë për këtë çështje, është i njëjti interpretim që dëshmohet edhe nga praktika e Profetit të Shenjtë të Islamit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.

Në Medinë, ku ai u vendos pas Hixhretit, ai ra në kontakt me hebrenjtë dhe njerëzit e bashkësive të tjera, të cilët nuk e pranuan atë si prijësin e tyre fetar, por e pranuan si prijës politik. Ata ranë në ujdi që ta pranonin vendimin e tij si vendim përfundimtar për të zgjidhur të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindnin mes grupeve të ndryshme. Kjo u quajt “Karta e Medinës”.

Ligji islamik ishte shpallur deri atëherë. Sa herë që hebrenjtë shkuan tek ai për të kërkuar udhëzim ose vendim, pa gabuar, çdo herë ai i pyeti: Doni t’ju zgjidhim mosmarrëveshjen sipas ligjit hebre apo sipas ligjit islamik apo sipas arbitrimit?

Pa përjashtim, ai kurrë nuk ia imponoi ligjin islamik një pale që nuk ishte dakord, që nuk i përkiste besimit të tij.

Kjo është ajo që unë quaj drejtësi absolute. Pra, drejtësia absolute duhet të zbatohet nga një qeveri e vërtetë islamike, nëse ajo ëndërron ta quajë veten “qeveri islamike”. Dhe kjo me fjalë të tjera është një qeveri shekullare.

P. Nëse doni të keni një legjislacion të ndryshëm; një legjislacion për hindutë, një për të krishterët e me radhë, mendoj se do të ishte tepër shqetësuese për shoqërinë.

PËR. Pikërisht, këtë po them. Unë nuk propozoj që çdo qeveri politike duhet të ketë një takëm legjislacioni për të aplikuar mbi fe të ndryshme. Nuk është e mundshme dhe nuk është praktike.

KOMENTET MBYLLËSE TË KRYETARIT

Ne këtu po punojmë së bashku. Kemi bashkësi fetare të ndryshme: të krishterët, hindutë, muslimanët dhe me sa duket po punojmë në baza të shëndosha, në bashkëpunim të ndërsjellë, pa ndërhyrë në çështjet e brendshme të asnjërës. Në emër të të gjitha organizatave, sinqerisht ju falënderoj dhe shpresoj që kur të lini vendin tonë, Surinamin, ta lini me mendime dhe kujtime të mira dhe, gjithashtu, duke lënë shumë miq këtu!

Ju uroj udhëtim të mbarë!

Rreth autorit

Hazret Mirza Tahir Ahmed (1928-2003), Allahu e mëshiroftë pafundësisht, një njeri i Zotit, zë i kohës, orator i madh, dijetar i thelluar me inteligjencë fenomenale, shkrimtar i gjithanshëm, studiues i mprehtë i shkencës krahasuese të feve, ishte prijës, Imam, udhëheqës shpirtëror i më shumë se 10 milionë ndjekësve të tij të devotshëm muslimanë ahmedianë anembanë botës dhe ishte Kalifi i Katërt i *Hazret Mirza Ghulam Ahmedit* (Mesihut të Premtuar a.s.) një detyrë në të cilën ai u zgjodh në vitin 1982.

Pas shpalljes së ligjit anti-Ahmedian, të datës 26 prill 1984, nga ana e diktatorit pakistanez gjeneral Zia-ul-Hak, *Hazret Mirza Tahir Ahmedit* iu desh të largohej nga Pakistani, vendi i tij i dashur, për të mërguar në Angli, nga ku do të lançonte kanalin MTA (Televizioni ndërkombëtar i Xhematit Musliman Ahmedia), i cili do të transmetonte (dhe vijon të transmetojë) emisionet e tij 24 orë në të katër anët e botës.

Hazret Mirza Tahir Ahmed ishte jo vetëm një lider fetar, por edhe një mjek i homeopatisë me famë botërore, një poet me dhunti të rrallë dhe një sportist.

Shkollën e mesme ai e nisi në Kadian, për ta vazhduar më pas në Kolegjin Shtetëror të Lahorit të Pakistanit. Pas përfundimit të shkollës së lartë me nota të shkëlqyeshme në Universitetin “Xhamia Ahmedia Rabvah” të Pakistanit, ai u diplomua për gjuhën arabe

nga Universiteti Panxhab i Lahorit. Nga 1955 deri në 1957, ai vijoi Shkollën e Studimeve Orientale dhe Afrikane në Universitetin e Londrës.

I inspiruar prej Zotit të Madhërishëm, ai shfaqti dituri të thella mbi Kuranin e Shenjtë, të cilin edhe e përktheu në gjuhën urdu, ashtu siç redakttoi pjesërisht përkthimin e tij në anglisht, të bërë nga *Hazret Maulvi Sher Ali r.a.*, duke i shtuar, gjithashtu edhe shënime shpjeguese. Vepra “Revelation, Rationality, Knowledge and Truth” është magnum opusi i tij.

Pavarësisht se ai nuk iu nënshtroi ndonjë arsimimi formal për filozofinë, kishte një prirje tejet të mprehtë në filozofi dhe për këtë arsye, diti të trajtonte edhe pyetjet më të vështira teologjiko-filozofike. Qasja e tij intelektuale gjithmonë ka qenë racionale dhe shkencore. Laikët befasoheshin nga dijet e thella shkencore që ai kishte, sidomos në shkencat e jetës, që e tërhoqën shumë. Me njohuritë e gjera mbi psikologjinë humane, me mendjen analitike të inteligjencës së lartë dhe me analizat brilante që bënte, ai magjepste dëgjuesit dhe lexuesit e tij.

Adresat

Shqipëri

Rr. "Pavarësia"
Mëzez, Tiranë
Kutia postare 8176
darulfalah@gmail.com

+355 672168054
+355 662974992
+355 695876901

Kosovë

Rr. "Holger Pedersen"
Lagjja e Spitalit,
Prishtinë
amj.kosovo@gmail.com

+377 44817813
+381 38558436
Fax: +381 38512408

www.alislam.al

Ndjeshmëria rreth çështjes së Sheriatit i ka polarizuar popujt. Sidoqoftë, fakti është që këto ekstreme janë ushqyer nga frika dhe keqkuptimi, për pjesën më të madhe të cilave përgjegjës të drejtpërdrejtë janë muslimanët. Autori analizon nga kënde të ndryshme kompleksitetin e implementimit të ligjit të Sheriatit. Cilësimi i tij është jashtëzakonisht i gjindshëm për strukturat moderne të qeverisjes në shoqëritë pluraliste. Megjithatë, në të gjitha përfundimet e tij, ai bazohet drejtpërdrejt në Kuranin Famëlartë, hadithet dhe praktikën profetike.

Ai gjithashtu nxjerr në pah hipokrizinë e dëshmuar rëndom në disa vende islamike. Ai me të drejtë i këshillon muslimanët që, së pari të reformojnë vetveten, përpara se të imponojnë në mënyrë tiranike mbi të tjerët interpretimin e tyre të ligjit të Sheriatit. Ai tregon se kombinimi i këtyre faktorëve ka krijuar situata, të cilat e bëjnë ligjin e Sheriatit jopraktik, madje, despotik dhe kundër asaj fryme, për të cilën ai ishte hartuar.

This is the Albanian translation of a speech entitled “Shariah—Relationship between Religion & Politics in Islam”, delivered by Hazrat Mirza Tahir Ahmad r.a., Khalifatul Masih IV.

www.alislam.al



ISBN 1-84880-260-9



9 781848 802605